

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-2/11

Prishtinë

13 korrik 2011

Në çështjen juridike të:

B.S.

Paraqitësi i kërkesës/Ankuesi

Kolegji i Ankesave i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, Gjyqtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/61/2010, (lënda është regjistruar në AKP me numrat KPA56144, KPA56106, KPA56133 dhe KPA56102), të datës 25 shkurt 2010, dhe KKPK/D/A/77/2010 (lënda është regjistruar në AKP me numrat KPA10497 dhe KPA10499), i datës 16 Qershor 2010, pas seancës gjyqësore të datës 13 korrik muarr këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Hidhet si e paafatshme Ankesa e B.S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) KKPK/D/A/61/2010, i datës 25 shkurt 2010, dhe KKPK/D/A/77/2010, i datës 16 qershor 2010.
- 2- Detyrohet ankuesi, B.S., që shpenzimet e procedurës në shumë prej € 60 (gjashtëdhjetë euro) ti paguajë në Buxhetin e Kosovës, nga mbrenda 15 ditëve nga dita kur aktgjykimi është dorëzuar, nën kërcënimin e detyrueshëm.

Zhvillimet procedural dhe faktike:

Me 14 dhjetor 2007, B.S., duke vepruar si anëtarë i familjes dhe në emër të babait të tij të vdekur, D.M., ka parashtruar kërkesë pranë Agjencionit Kosovar të Pronës (AKP) lidhur me këto palujtshmëri:

- ngastra kadastrale nr. 434 në vendin e quajtur "Ispod Rudine Slatina", klasa e 4-të, me kulturë arë, në sipërfaqe prej 0.33.15 ha (KPA10497; GSK-KPA-A-2/11);
- ngastra kadastrale nr.727 në vendin e quajtur "Ulica Barica", klasa e 4-të, arë/tokë ndërtimore e zbrazët, në sipërfaqe prej 0.07.54 ha (KPA10499; GSK-KPA-A-7/11).

Më 27 dhjetor, përsëri duke vepruar si anëtarë i familjes dhe në emër të babait të tij tashmë të ndjerë, ka parashtruar tjetër kërkesë në AKP, kësaj radhe në lidhje me këto palujtshmëri:

- ngastra kadastrale nr. 1619 në vendin e quajtur "Gurina Zarepak", klasa e 7-të, arë, në sipërfaqe prej 0.23.30 ha (KPA56133; GSK-KPA-A-3/11);
- ngastra kadastrale nr. 1039 në vendin e quajtur "Gracko", klasa e 5-të, arë , në sipërfaqe prej 0.33.19 ha (KPA56114; GSK-KPA-A-4/11);
- ngastra kadastrale nr. 896 në vendin e quajtur "Osishte Ulica", klasa e 4-të, arë, në sipërfaqe prej of 0.67.25 ha (KPA56106; GSK-KPA-A-5/11);
- ngastra kadastrale nr. 773 në vendin e quajtur "Mala Kanarishte", klasa e 4-të, arë në sipërfaqe prej 0.27.50 (KPA56102; GSK-KPA-A-6/11).

Parashtruesi i kërkesës ka theksuar se ai është djali i pronarit të palujtshmërisë dhe se posedimi i palujtshmërisë ka humbur me 1 qershor 1999 si rezultat i rrethanave në vitin 1998/99. Ai ka kërkuar riposedimin dhe kompensimin për shkak të privimit të tij nga shfrytëzimi i palujtshmërisë që nga ajo kohë.

Me qëllim që të mbështesë kërkesën e tij ai i ka paraqitur AKP-ës këto dokumente:

- Fletën Poseduese nr.101, lëshuar nga UNMIK-u, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë e Komunës së Lipjanit, Zona Kadastrale Kraishte, e regjistruar me numër 676/04 datë 07 korrik 2004, duke treguar se palujtshmëria kontestuese ishte në posedim të D.S.M.; dhe

- Ektraktin nr. 01-203-26 nga Regjistri i Vdekjes, i datës 22 shkurt 2001, lëshuar nga Komuna e Nishit për Komunën e Lipjanit, duke treguar se D.M. ka vdekur me 20 Shkurt 2001 nëLipljan.

Në vitin 2008 dhe 2009 zyrtarët e AKP-ës kanë shkuar ne vendin e ndodhjes së parcelës kontestuese dhe kanë vendosur njoftimin duke cekur se kjo palujtshmëri është objekt kërkesës së paraqitur, dhe që palët e interesuara duhet të paraqesin përgjigjen e tyre mbrenda muajit. Ata kanë vërejtur se palujtshmëria konstestuese në lëndët me numër KPA10499, KPA56133 dhe KPA10497 nuk është uzurpuar, ndërkaq që palujtshmëria në lëndët me numrat KPA56102 (arë), KPA56106 (kullosë) dhe KPA56114 (arë) ishte uzurpuar. Uzurpuesit e palujtshmerive nuk kanë mund të identifikohen. Më vonë në procedurë, AKP-ja ka kontrolluar njoftimin dhe në bazë të “ortofotos dhe kordinatave të GPS” ka konfirmuar se njoftimi është bërë në mënyrë të saktë. Nuk ka pasë ndonjë përgjeje nga asnjë palë përgjegjëse në kërkesë.

Meqenëse, mbiemri i paraqitësit të kërkesës ka ndryshuar nga mbiemri i bartësit të të drejtës pronësore, AKP-ja ka kërkuar disa herë nga paraqitësi i kërkesës (24 shkurt 2009, 17 mars 2009, 6 maj 2009, 8 shtator 2009, 3 nëntor 2009) fakte të tjera që do të mund të provonin me vërtetësi se ai ka qenë djali i bartësit të të drejtës pronësore, tanimë i ndjerë. Ai ka qenë i informuar se nëse nuk i ofron dokumentet e kërkuara kërkesa e paraqitur e tij do të hudhet poshtë. Pala përgjegjëse është pajtuar që t'i dorëzojë dokumentet e kërkuara, por ai nuk e ka bërë këtë.

Me 25 shkurt 2010 KKPK-a me vendimin e saj KKPK/D/A/61/2010 ka hedhur (në mes të tjerash) kërkesat KPA56144, KPA56106, KPA56133 dhe KPA56102 për shkak të pamundësisë së provimit se ai është anëtarë i familjes.

Me 16 qershor 2010, KKPK-ja me vendimin e saj KKPK/D/A/77/2010 ka hudhur poshtë në (mes të tjerash) kërkesat KPA10497 dhe KPA10499 për shkak të pamundësisë së provimit se ai është anëtarë i familjes.

Në të dyja vendimet kërkesa për kompenzim është hudhur poshtë sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar sipas Ligjit Nr.. 03/L-079, për shkak se komisioni nuk kishte jurisdiksion të vendostë në kësi lloj ankesash.

Paraqitësi i kërkesës (tani e tutje: ankuesi) ka pranuar vendimin KPCC/D/A/61/2010 dhe gjithashtu edhe vendimin KPCC/D/A/77/2010, i datës 10 dhjetor 2010. Ai ka ushtruar ankesë në secilën nga kërkesat e e AKP-ës me datë 17 janar 2011, duke theksuar se vendimet ishin jo të drejta dhe me gabime. Me qëllim që të mbështesi ankesat e tija ai ka paraqitur vetëm Fletën Poseduese nr. 101, por edhe vendimin T.nr.233/2008, të datës 1 dhjetor 2009, lëshuar nga Gjykata Komunale në Lipljan. Me këtë vendim Gjykata Komunale ka vendosur që midis të tjerëve B.S., djali i D.M., ishte trashëgimtar i rendit të parë në ngastrat kadastrale 434, 727, 773 dhe 1039. Trashëgimtare ne ngastrën kadastrale 896 ishte shpallur B.J., vajza e të ndjerit, trashëgimtar i ngastrës kadastrale 1619 T.M., djali i të ndjerit.

Gjykata Supreme ka pranuar ankesat me 1 shkurt 2011 dhe ka bashkuar ato.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e papranueshme.

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK 2006/50 e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079 cek me sa vijon: *“mbrenda tridhjetë (30) ditësh nga njoftimi i palëve prej Agjencionit Kosovar të Pronës për vendimin e Komisionit në lidhje me kërkesën e paraqitur, pala mund të paraqes ankesë kundër vendimit në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Pronës”*

Me 10 dhjetor 2010 ankuesit i janë dorëzuar të dy vendimet, kështuqë afati kohor ka përfunduar me 10 Janar 2011. Sidoqoftë, ankuesi ka ushtruar ankesën e tij vetëm me 17 Janar 2011. Kjo është jashtë afatit kohor. Ai nuk ka dhënë ndonjë sqarim për këtë dhe Gjykata nuk ka mund të vërej ndonjë nga arsyet e vonesës.

Prandaj, ankesa duhet të hudhet se e paafatshme për shkak të arsyeve procedurale (neni 13.3, nënparagrafi (b) i Rregullores së UNMIK -ut 2006/50 e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079).

Në përputhshmëri me këtë, nuk është e nevojshme që gjykata të vendos nëse vendimi i paraqitur mbi trashëgiminë ka qenë dashur të mirret në konsideratë. Në përgjithësi prova e re nuk është shqyrtuar nga gjykata (Neni 12.11 i Rregullores së UNMIK 2006/50, i amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079), përderisa nuk provohet se ai fakt nuk ka mundur të ishte i njohur nga palët në procedurë.

Meqenëse vendimi mbi trashëgiminë ishte marrë me datë 1 dhjetor 2009, kjo d.m.th se ai ishte marrë pothuajse 3 muaj para marrjes së vendimit të KKKP-ës, që del se ankuesi ka mund të shfrytëzojë këtë provë në procedurën para KKKP-ës.

Gjykata Supreme ka vërejtur se vendimi i KKKP-ës nuk është në kundërtë me aktvendimin e trashëgimisë të Gjykatës Komunale të Lipjanit, i paraqitur nga ankuesi.

Shpenzimet e procedurës:

Në përputhje me nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UD) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr: 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës që zhvillohet para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë një përjashtim i tillë nuk parashihet edhe për procedurën para Gjykatës Supreme.

Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Shpenzimet Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UD Nr:2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Shpenzimeve Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Gjykatës Supreme.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Gjysa e taksës nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (neni 10.15, 10.21 dhe 10.1 i UA 2008/2), por jo më shumë se € 30, duke pas parasysh se vlera e palujtshmërisë në fjalë, mund të llogaritet së paku € 70.000: 30 €.

Këto taksa gjyqësore do të barten nga ankuesi e cili e humb rastin.

Në përputhje me Nenin 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhën mbrenda afatit kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nën kërcënimin e detyrimit të detyrueshëm në rast të mospagesës mbrenda afatit, duke përfshirë edhe urdhërin për gjobën ashtu siq është e përcaktuar me nenin 47 të të njejtut ligj.

Udhëzim juridik

Sipas Nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, i amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotëfuqishëm dhe I formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet as me mjete të rregullta as të jashtëzakonshme juridike.

Antoinette Lepeltier-Durel, EULEX Presiding Judge

Anne Kerber, EULEX Judge

Sylejman Nuredini, Judge

Urs Nufer, EULEX Registrar